

**VENDIM**  
**Nr.18, datë 19.1.2007**

**PËR DHËNIEN E FONDIT PËR SUBJEKTET, PJESËMARRËSE NË ZGJEDHJE, PËR  
FINANCIMIN E FUSHATËS ZGJEDHORE PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE  
TË VITIT 2007**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 21 e 27 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë” dhe të nenit 12 të ligjit nr.9645, datë 27.11.2006 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2007”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Dhënien e fondit prej 60 000 000 (gjashtëdhjetë milionë) lekësh, për subjektet, pjesëmarrëse në zgjedhje, për financimin e fushatës zgjedhore për organet e qeverisjes vendore të vitit 2007.
  2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.
  3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Komisioni Qendror i Zgjedhjeve për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**